



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:059020

Datë: 29.03.2022

Numri i dokumentit: 02854635

P.nr.100/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Selman Salihi, me pjesëmarrjen e praktikantes si procesmbajtëses Hanife Ibrahimi dhe përkthyesit Suad Bikliqi, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurit J. D. , të cilët i akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.928/2022, të datës 26.03.2022 për shkak veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datën 26.03.2022 , në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Elza Bajrami Kastsrati , të pandehurit, dhe mbrojtëses të tij sipas detyres zyrtare Naser Morina , me të njejtën ditë, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurve

- 1. J. D.** , nga i ati M. , i lindur me datën *data e lindhjes* ne B.–T. i pa martuar me nr. pasaporta turke *numri...* shtetas i Republikës së T. cili gjendet në ndalim prej 26.03.2022 në ora 7.45 minuta , deri me datën 26.03.2022 14.30 minuta

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 26.03.2022 rreth ores 7.45 ne aeroportin Nderkombtar te Prishtine , Adem Jasharit gjate kontrollit te dokumentrave ne shkuarje ka perdorur poasaoporten franceze te fallsifikuar ne emer te personit C.I. me nr. *numri...* per te udhetuar ne drejtim te dezendollfit ne Gjermani ne ate menyre qe i pandehuri me dashje ka perdorur kete dokument me qellim te shfrytezimit te keti dokumenti si origjinal me vende te treta ku inditifikimi i te pandehurit eshte bere nga policia me pasaporten e Turqise .Ashtu qe ne baze te raoportit te fornizikeks te pranuar nga agjencia e Kosoves me nr. AKF2022/108220221074 pasapoorta me deshmin D1 eshte e prodhuar sipas teknologjis standarte te prodhimit por dokumenti ne fjale ka nderhyrje ne faqen e te dhenave duke e vendosur nje faqe te procenalizuar e cila nuk i posedon tiparet mbrojtese te siguris dhe eshte pjesisht e fallsifikuar.

-me këtë ka kryer veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së,

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 20, 21, 38, 39, 40, 43, 69,70,71 75, dhe nenit 390 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me dënim me Burg ne kohezgjatje prej 3(tremuajsh)

I cili denim me pelqimin e te pandehurit i zevendsohet prej denimit me burge ne ate me gjobe ne shume prej 200 euro .

Me denim me gjobe ne shume prej 150(njiqindpesdhjeteuro)

Te pandehurit i shqiptohet denimi Unik konform nenit 76 te KPRK-se paragrafi 2 .4 ne shume prej 350 euro .

Konform nenit 282 par. 2 nenpar.2.5 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet:

DENIM PLOTËSUES

Konfiskohen pasaporta e franceze me nr. 15AA0328 ne emer te Cem Iscan .

Konform nenit 115 paragrafi 1 dhe 2 perkatesisht nen par 2.1 te KPRK-se .

Gjithashtu gjykata shqipton denimin plotesus ‘‘Debimi i te Hujave’’ nga Republika ee Kosoves ne kohezgjatje prej 2 viteve e cila mase do te ekzekutohet na drejtoria për migrim shtetesi dhe azil e Republikës se Kosoves prane Policise se Kosoves.

OBLIGOHET i pandehurit që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor t’ia paguaj shumën prej 20.€, dhe për për kompensimin e viktimave të krimit t’ia paguaj shumën prej 30. €, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzen e saj PP.II.nr.928/2022 të datës 26.03.22, i ka akuzuar të pandehurit J. D. ,për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar përfaqësuesi i Prokurorisë ka propozuar qe ndaj te pandehurit te caktohet masa e paraburgimit per shkak se ekzistojne bazat qe eshte dyshimi i bazuar dhe i vertetuar per ngritjen e aktakukzes dhe ekziston rreziku i ikjes sepse i pandehuri nuk eshte shtetas i Kosoves dhe poqese largohet nga Kosova nuk do te kete mundesi qe sigurohet prezenca e tij dhe se ekziston pesha e vepres penale sepse ekziston nje veper penale e denuar me gjobe dhe burgim .

I pandehuri në shqyrtimin fillestar deklaroi :se e ndij veten fajtor dhe e pranoi fajsinë me vullnetin tim pa presion me vetedije te plote dhe jam i bindur per pasojat e pranimit te fajses ne konsulltim paraprak me brojtesin tim –nuk e kam ditur se eshte dokumenti i fallsifikuar jam i penduar per kete nuk e kundershtoj aktakukzen nuk e perseris vepren openale dhe me vjene keq qe kam thyer ligjet e Kosoves .

Mbrojtësi i të pandehurit av.Naser Gashi deklaroi konsideroj se i pandehuri pranoi fajsinë dhe shpreh pendesë për këtë i propozoj gjykatës që të marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajsisë dhe të nderprerë masën e paraburgimit.

Gjyqtari i vetëm gjykes, i bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të t'pandehurve, për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e përcaktimit të llojit të dënimit dhe të lartësisë së tij gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj të pandehurit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata për të pandehurin, e vlerësoi, faktin se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, pendimin për veprimet e bëra, premtimin e dhënë gjykatës se në të ardhmën nuk do ta përsëris veprën penale, e veçanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi sugurin e qarkullimit dhe levizjes së pasagjerve perkatesisht qytetarve në pikat e kontrollit kufitar duke e shmangur veprimet e kunderligjeshme dhe kalimet ilegale e në veqanti me dokumente fallce siq është rasti konkret. pra faktin se i pandehuri ka qenë ia aftë të kuptojë sjelljet dhe veprimet e tij, dhe duke marrë për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, gjykata konform nenit 69 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi, dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për paushallin gjyqësor u bazua në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.6 të KPRK-së, vendimi mbi shpenzimet e Financimit të Kompenzimit të Viktimave të Krimin bazohet në nenin 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimin.

Vendimin për konfiskimin e pasaportës u bazua në nenin 282 par. 2 nënpar.2.5 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.
P.nr.100/2022 i dt.26.03.2022

Procesmbajtësja
Hanife Ibrahim

GJYQTARI
Selman Salih

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.